



Pranuar / Dorezuar Primjetat/Prodato Received/Delivety	19.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHOK	4360/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.581/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.581/2023 të datës 29.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 19.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me A.nr.581/2023 e datës 29.03.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Detyrohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 19.01.2023, të parashtruar nga ankuesi

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prizrenit sipas Akt emërimit të datës 20.06.2016, në pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Sportit” në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Spektori i Sportit, me datën 17.01.2023 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar kërkesë tek Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Administratës lidhur me rregullimin e pagesave të përvojës së punës dhe kompensimit të saj, e cila kërkesë tek kjo e fundit është pranuar me datën 19.01.2023.

Komuna e Prizrenit, përkundër detyrimit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ konform kërkesës së ankuesit, nuk ka vepruar komfor këtij detyrimi ligjor-nuk ka nxjerrë akt administrativ.

I pakënaqur me mos nxjerrjen e aktit administrativ nga Komuna e Prizrenit, në afatin e paraparë ligjor e në kuptim të nenit 127 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes përfaqësuesit me autorizim me datën 27.03.2023 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3089/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar me datën 29.03.2023, me pretendimet ankimore për shkak të: shkeljeve të dispozitave ligjore të procedurës administrative si dhe zbatimit të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 31.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa Këshilli me datën 11.05.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankuesit nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 10.05.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 3089/2023 të datës 29.03.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën zyrtare me Nr. të pranimit 2636366 të datës 17.01.2023 lidhur me dërgimin e kërkesës tek Komuna e Prizrenit; Kërkesën e ankuesit të datës 16.01.2023 lidhur me rregullimin e pagesave të përvojës së punës dhe kompensimit të saj tek komuna; Autorizimin e datës 16.01.2023 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.05.2023 nga Komuna e Prizrenit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 20.06.2016; Vërtetimin me Nr.01-113-4621/01 të datës 12.01.2023 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Fletë dorëzimit me Nr.02/85 të datës 19.01.2023 lidhur me pranimin e shkresës zyrtare nga Komuna e Prizrenit; Dëshminë lidhur me pranimin e vendimit nga ana e përfaqësuesit me autorizim të datës 19.01.2023 si dhe Vendimin VK/2023 të datës 10.05.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për detyrimin e organit punëdhënës, respektivisht Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të vendosur lidhur me kërkesën e datës 19.01.2023 e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...". Ndërlidhur me këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: "Përveç kur përjashtohet

shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë njetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë së i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik". Përkatësisht sipas këtyre dispozitave ligjore rezulton se çdo nëpunës civil i cili pretendon një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) të organit gjegjes të punësimit, ka të drejtë të parashtoj ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nenit 98 me të cilin është përcaktuar se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj...",* si dhe nenit 127 paragrafi 4 me të cilin parashihet se: *.... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ".* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit në Këshill është e pranueshme dhe se pretendimet ankimore të tij lidhur me heshtjen administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e datës 19.01.2023 janë të bazuara.

Andaj, përkitazi me kërkesën e ankuesit të datës 19.01.2023, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës nuk ka gjetur dëshmi se Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit është përgjigjur në kërkesën e ankuesit, kështu që bazuar në nenin 97 paragrafin në Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 1 ku parashihet se: *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ...,* Kolegji vlerëson se Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit duhet të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 19.01.2023 dhe të nxjerrë akt administrativ bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit e në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.581/2023, datë 19/05/2023.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.